

ANALIZË E SHKURTËR  
Planifikim urban për qytetarët 4  
Autore: Rozafa Basha  
dhjetor 2015, Prizren

PËRMBAJTJA

I. Përmbledhje ekzekutive .....	2
II. Hyrje .....	3
III. Projekti për planifikimin me pjesëmarrje .....	5
IV. Struktura dhe metodologjia e hulumtimit.....	6
V. Rezultatet .....	8
VI. Konkludim .....	28
EC Ma Ndryshe .....	32

*Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, i përkrahur financiarisht nga Olof Palme International Center.*



**OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)**

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren ~ Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-5, 10000 Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) ~ [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) ~ 038-224-967 & 029-222-777

## I. Përmbledhje ekzekutive

Kjo analizë e shkurtër mëton të paraqesë shqetësimet kryesore të qytetarëve të Prizrenit në lidhje me çështjet e planifikimit urban dhe menaxhimit të qytetit në përgjithësi. Analiza e prezantuar këtu është e katërta me radhë që realizohet brenda një periudhe 3 vjeçare në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”. Ky projekt është financuar nga Olof Palme International Centre dhe ka për qëllim që t’i artikulojë nevojat e grupeve të komuniteti në mënyrë që ato të merren parasysh nga autoritetet lokale gjatë hartimit të planeve urbane nga Komuna e Prizrenit. Gjatë këtyre 3 viteve, në hulumtim janë përfshirë 1299 respondentë, përfshirë këtu edhe anketimin e fundit, në bazë të cilit po ndërtohet kjo analizë, që përfshin anketimin e 499 të intervistuarve të grupmoshave të ndryshme nga 9 lagje në qytetin e Prizrenit. Organizimi i hulumtimit të katërt dhe përgatitja e metodologjisë është realizuar nga kompania Global Consulting & Development Associates sh.p.k.

Problemet që ndërlidhen me menaxhimin urban të Prizrenit dhe të qyteteve të Kosovës në përgjithësi aktualisht janë të shumta. Shumë prej tyre ndërlidhen ngushtë me praktikën aktuale të planifikimit dhe vendimmarrjes për hapësirën urbane. Janë disa institucione në Kosovë që e kanë përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të vënies së rendit urbanistik në Kosovë (në nivelin qendror dhe lokal). Procesi i planifikimit prej pas luftës e deri më tani, kryesisht ka përfshirë profesionistët, të cilët të dhënat dhe statistikat zyrtare i shndërrojnë në plane, pa lidhje të veçantë me komunitetin dhe mjedisin për të cilin ato plane përgatiten. Planet e përfituara kësisoj, kryesisht nuk

korrespondojnë me kapacitetet e komunave në të cilat duhet të zbatohen, dhe vendet e prodhuara prej një procesi të këtillë nuk reflektojnë me ndjenjën e vendit dhe të pronësisë për popullatën banuese. Për pasojë, sot në Kosovë është më se evidente se qytetet dhe hapësira publike, në veçanti, trajtohen me neglizhencë, si nga qeverisja lokale po edhe nga qytetarët, meqë vendimet për hapësirën urbane merren ekskluzivisht nga lartë, pa pasur dialog me qytetarë – shfrytëzuesit e atyre hapësirave.

Pjesëmarrja qytetare në planifikim urban është paradigmë e planifikimit urban, që vë në pah përfshirjen e komunitetit në proceset strategjike dhe menaxheriale të qytetit, si dhe në proceset e planifikimit urban, dhe të komunitetit në përgjithësi. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e planifikimit urban, në Kosovë rregullohet me dispozita ligjore në fuqi. Sipas tyre, kjo pjesëmarrje kufizohet në komentimin e planeve zhvillimore që shpalosen për një periudhë kohore, para miratimit zyrtar. Tashmë ekzistojnë praktika të izoluar të përfshirjes së komunitetit në proces të planifikimit urban, që kryesisht zbatohen falë vullnetit dhe praktikës profesionale të disa studiove planifikuese. Nevoja për përfshirjen e një publiku më të gjerë në këto procese njihet tashmë edhe nga institucionet vendimmarrëse, por nismat për zbatimin e praktikave të tilla në procesin e planifikimit urban në Kosovë megjithatë janë në nivel simbolik.

Përfshirja e gjerë e publikut në procesin e planifikimit urban siguron që ato plane të jenë relevante dhe të zbatueshme si dhe që hapësira urbane apo vendbanimet e krijuara prej një procesi të tillë t’i shërbejnë më mirë banorëve të vet gjatë gjithë jetës.

Kjo analizë, në këtë moment, përpos identifikimit të problemeve urbane në Prizren, me të cilat qytetarët përballen përditë, por edhe të nevojave të tyre për një jetë më cilësore në qytet, mëton që të prezantojë praktika të reja, të cilat do të mund të zbatoheshin lehtë nga pushteti lokal, por edhe nga organizatat e komunitetit. Praktikant e përfshirjes sa më të madhe të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes për qytet, krahas adresimit të nevojave reale të qytetarëve, ndihmojnë në ndërtimin e një qytetarie aktive ndër komunitetet e lagjeve dhe qytetit në përgjithësi. Qytetaria aktive, në anën tjetër, përmes fuqizimit politik, iu mundëson qytetarëve t'iu ngrënë dhe drejtojnë pyetje politike dhe teknike autoriteteve që kanë të bëjnë me planifikimin dhe menaxhimin e qytetit. Mes tjerash, përmes kësaj, qytetarëve do t'iu mundësohet t'i njohin edhe mjetet themelore të veprimit politik, siç janë hulumtimi, komunikimi, lobimi dhe mendimi strategjik.

Dhe të gjitha këto me një qëllim të përbashkët: të arritjes së një mirëqenieje më të madhe për të gjithë.<sup>1</sup>

## II. Hyrje

Qyteti është një kolektiv ose një e mirë e përbashkët, në të cilin banorët urbanë i bashkëndajnë pasuritë e tij – prej hapësirave publike, parqeve, rrugëve dhe ndërtesave deri te kultura e atij qyteti. Qyteti është e përbashkëta urbane dinamike, që bashkëndahet prej individëve dhe prej kolektivëve të ndryshëm, jo rrallë të mbivendosur. Heterogjeniteti dhe diversiteti

janë tiparet themelore të një mjedisi urban.<sup>2</sup> Çështjet që ngrihen gjithnjë e më shumë nga lëvizjet urbane sot në botë, ngërthejnë shqetësimet rreth ruajtjes së dinamikës së qyteteve, si dhe lejimit që ato të ndryshojnë dhe zgjerohen për pa i shkatërruar dhe degraduar të mirat dhe pasuritë që janë vitale për jetën dhe përparimin e njerëzve dhe klasave të ndryshme. Por edhe, si të mundësohet shpërndarja e pasurive (të fundme) të qytetit, ashtu që një numër i madh dhe i ndryshëm i qytetarëve të kenë qasje në të?<sup>3</sup>

Sipas Ali Madanipour, planifikimi dhe zhvillimi i qyteteve janë procese të vazhdueshme dhe të ndërlikuara, përmes së cilave individët dhe organizatat, bazuar në nivelet e fuqisë dhe të ndikimit politik, ekonomik dhe kulturor i japin formë dhe i përcaktojnë disa tipare të hapësirës urbane, duke krijuar kështu kondita strukturore, brenda të cilave të tjerët jetojnë dhe e shfrytëzojnë qytetin. Shpeshherë, më të pushtetshmit, falë pasurisë dhe qasjes në burime që kanë dhe përmes individëve dhe institucioneve të fuqishme ku kanë ndikim, mundësojnë ndryshime fizike dhe institucionale në qytet, ndërsa kërkesat e grupeve më pak të fuqishme, mund të mos merren parasysh ose mund të marrin forma më të buta apo të përkohshme.<sup>4</sup> Një hapësirë urbane e prodhuar kështu, nuk iu përgjigjet nevojave të gjithë

<sup>2</sup> Basha, R., Planifikimi urban për qytetarët 3, EC Ma Ndryshe, tetor 2014, [http://ecmandryshe.org/repository/docs/150203145824\\_EC\\_Planifikim\\_Urban\\_per\\_Qytetaret.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/150203145824_EC_Planifikim_Urban_per_Qytetaret.pdf)

<sup>3</sup> Foster, S., artikulli: Cities, Inequality and the Common Good, Huffingtonpost, 30.10.2015, [http://www.huffingtonpost.com/sheila-foster/cities-inequality-and-the\\_b\\_8435316.html](http://www.huffingtonpost.com/sheila-foster/cities-inequality-and-the_b_8435316.html)

<sup>4</sup> Whose Public Space?: International Case Studies in Urban Design and Development (p. 237). Taylor and Francis. Kindle Edition. (2010)

<sup>1</sup>Basha, R., Planifikimi urban për qytetarët 2, EC Ma Ndryshe, dhjetor 2013

banorëve të vet, reflekton pabarazi sociale dhe dominim të interesave të caktuar ekonomike dhe politike. Një qytet i tillë, i shërben më së paku mbajtjes së publike si tipar themeltar që mund të lidhë një komunitet apo gjithë qytetarët bashkë.

Janë të shumtë individë, grupe dhe organizata që shtrojnë kërkesa dhe kanë pretendime mbi qytetin. Marrja në konsideratë të veç njërës anë, plotëson dëshirat për ekskluzivitet që secila prej tyre mund të ketë në një hapësirë urbane. Për t'i evituar veprimet që mund të prodhojnë situatat që u lartpërmendën, planifikimi i qytetit duhet të ndërtohet në kryqëzim të pretendimeve dhe kërkesave të grupeve të ndryshme. Kërkesat e këtyre grupeve mund të jenë kundërthënëse, andaj zgjidhjet për një qytet të drejtë që do t'iu shërbente të gjithëve duhet të negociohen. Këto negociata mund të realizohen në mënyrë të suksesshme vetëm përmes proceseve gjithëpërfshirëse të projektimit dhe zhvillimit të qytetit.<sup>5</sup>

Qyteti ngërthen në vete shumë shtresa me vlera të caktuara që ndërliken me individë dhe bashkësitë e ndryshme që e përbëjnë atë qytet, dhe secila nga to duhet të adresohet gjatë proceseve të projektimit dhe zhvillimit të qytetit. Proceset gjithëpërfshirëse të planifikimit të qytetit janë tipare të një demokracie lokale, me një qytetari të fuqizuar dhe të përgjegjshme që reflekton me një menaxhim cilësor, para së gjithash të hapësirës publike, dhe të gjithë qytetit në përgjithësi.

Në shoqëritë demokratike presim që zëri i secilit të përfaqësohet në proceset e vendimmarrjes për qytetin nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në kuvendet dhe këshillat e qytetit. Por shpeshherë, qeveritë dhe këshillat lokale

nuk e kryejnë punën e vet, pra nuk e mbrojnë "interesin publik". Proceset politike karakterizohen prej formave jo të shëndosha të dominimit të interesave private dhe mundësitë për pjesëmarrje demokratike nuk janë edhe aq lehtë të arritshme<sup>6</sup>. Qeveritë lokale, kanë tendencë që të akomodojnë preferencat e interesave të fuqishme ekonomike në vendimmarrje për zhvillimin e qytetit.

Në realitet, përfaqësuesit në këshillat lokalë, në të shumtën e rasteve nuk e përfaqësojnë zërin e grupeve të marginalizuara, dhe jo rrallë, gjithëpërfshirja në proceset vendimmarrëse, kontrollohet dhe ngushtohet nga grupime të caktuara politike, të cilat, për arsye të interesave politike dhe ekonomike që i mbrojnë, për të siguruar kthimin e investimeve, por edhe për të lehtësuar proceset komerciale, dëshirojnë që të kenë ekskluzivitet në vendimmarrje në lidhje me qytetin<sup>7</sup>, me çka i pengojnë grupimet e marginalizuara nga e drejta për zë në ndërtimin e politikave mbi qytetin dhe kontribuojnë në pabarazi të përgjithshme shoqërore.<sup>8</sup>

Qeverisja e mirë urbane, si një nga idetë themeltare të qytetit gjithëpërfshirës, duke pasur në qendër të shqetësimeve të veta njeriun, mëton të ndërtojë partneritet me qytetarët e bizneset dhe të kontribuojë në krijimin e ndjenjës së komunitetit mes njerëzve.

<sup>6</sup> Alexander, D. Citizen Learning, Sustainability and the Education of Citizen Activists, [http://newcity.ca/Pages/citizen\\_learning.html](http://newcity.ca/Pages/citizen_learning.html)

<sup>7</sup> Whose Public Space?: International Case Studies in Urban Design and Development (p. 239). Taylor and Francis. Kindle Edition. (2010)

<sup>8</sup> Basha, R., Planifikimi urban për qytetarët 3, EC Ma Ndryshe, tetor 2014, [http://ecmandryshe.org/repository/docs/150203145824\\_EC\\_Planifikim\\_Urban\\_per\\_Qytetaret.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/150203145824_EC_Planifikim_Urban_per_Qytetaret.pdf)

<sup>5</sup> Po aty.

### III. Projekti për planifikim me pjesëmarrje

“Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” është projekt trevjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t’i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Projekti përkrahet nga Olof Palme International Center dhe ka filluar së zbatuari në muajin janar 2013.

Grupet e komunitetit me të cilat është punuar në këtë projekt gjatë vitit 2015 kanë qenë të shpërndara në lagje të ndryshme të qytetit dhe paralelisht është zhvilluar edhe procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe institucionet tjera publike për të adresuar kërkesat e qytetarëve.

Grupet e komunitetit me të cilat është punuar më intensivisht, në vitet 2013 dhe 2014 në kuadër të këtij projekti janë: gratë, të moshuarit, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, banorët e lagjeve të varfra, kultura dhe mjedisi. Me secilin grup të komunitetit, gjatë një viti të projektit, janë organizuar katër fokus grupe dhe një debat publik, ndërsa paralelisht është zhvilluar procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin urban të qytetit.

Përveç veprimeve të mobilizimit dhe zhvillimit komunitar, projekti ka realizuar edhe një numër performansash publike, të cilat kanë shërbyer si përkujtues për obligimet e komunës ndaj qytetarëve dhe në të njëjtën kohë kanë prodhuar zgjidhje konkrete për problemet ekzistuese në hapësirën publike.

Planifikimi urban në Kosovë është një aktivitet teknik dhe i udhëhequr nga ekspertët, që kryesisht bazohet në të dhënat ekzistuese dhe ka pak ndërlidhje me mjedisin (kontekstin) për të cilin hartohet. Kjo praktikë kryesisht prodhon plane që janë jashtë kapacitetit realizues të qeverisë lokale dhe për më tepër, ajo nuk e reflekton realitetin në terren, me ç’rast qytetarët nuk kanë ndjenjë përkatësie. Pjesëmarrja e qytetarëve kufizohet brenda një periudhe të caktuar disa-ditore dhe kryesisht disa ditë para miratimit përfundimtar të planeve.

Ekziston një nevojë imanente për përfshirjen e interesave dhe aspiratave që qytetarëve në planet urbane, e sidomos të atyre grupeve që jetojnë janë të provuara nga infrastruktura dhe shërbimet adekuate publike. Pjesëmarrja e gjerë e qytetarëve është qenësore që planet urbane të jenë relevante dhe të zbatueshme. Planifikimi urban gjithëpërfshirës ndihmon edhe procesin e demokracisë lokale, duke inkurajuar përfshirjen qytetarë në të gjitha nivelet e procesit. Kjo qasje e re e urbanizmit (Urbanizmi i Ri) sfidon modelin aktual në Kosovë (planifikimin socialist të qyteteve), i cili ofron shumë pak hapësirë për qytetarin.

Projekti ka synuar përmbushjen e këtyre objektivave specifike: [a] Të zhvillojë metodologji dhe qasje gjithëpërfshirëse në planifikimin urban, [b] Të sigurojë lidhjen e munguar mes qytetarëve dhe planerëve urbanë, [c] Të zhvillojë ndjenjën e përkatësisë së qytetarëve për mjedisin rrethues të jetesës, [d] Të përkthejë interesat dhe nevojat e qytetarëve në plane të zbatueshme urbane, [e] Të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të grupeve të disfavorshme dhe të marginalizuara të shoqërisë, [f] Të promovojë qasjen e integruar

të planifikimit urban (social, ekonomik, mjedisor dhe kulturor)

#### IV. Struktura dhe metodologjia e hulumtimit

Për realizimin e këtij hulumtimi, kompania Global Consulting & Development Associates Sh.p.k. ka bërë organizimin e hulumtimit, përgatitjen e metodologjisë së punës. Përmes këtij hulumtimi janë ndërthurë dy forma të mbledhjes së të dhënave, ato **kualitative dhe kuantitative**. Hulumtimi kuantitativ është realizuar përmes intervistave me pyetësor me të anketuarit dhe janë bërë gjithsej **499 intervista** në nëntë lagje, duke e përfshirë edhe qendrën e qytetit. Të intervistuarit kanë qenë të grupmoshave dhe grupeve etnike të ndryshme.

Sa i përket pjesës së hulumtimit kualitativ, Global Consulting & Development Associates e ka realizuar përmes organizimit dhe implementimit të një **fokus grupi**, me grupe të interesit, të cilat i kanë paraqitur pikëpamjet e tyre rreth çështjes së urbanizimit në komunën e Prizrenit. Pjesëmarrësit e fokus grupit kanë qenë përfaqësues të lagjeve me të cilat EC Ma Ndryshe bashkëpunon.

Mbledhja e të dhënave në terren është bërë në lagjet me të cilat organizata EC Ma Ndryshe bashkëpunon. Lagjet e përfshira në hulumtim janë:

- Qendra
- Lagjja Bajram Curri
- Lagjja e transitit – Arbana
- Lagjja Tabakhane
- Lagjja Bazhdarhanë
- Lagjja Dardania
- Lagjja Nënkalaja
- Lagjja Qyk Mahalla
- Lagjja Ortakoll

- Lagjja Tusuzi

Mostra e hulumtimit të realizuar në komunën e Prizrenit rreth temës “Qyteti gjithëpërfshirës - planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” është realizuar gjatë muajit tetor dhe nëntor 2015.

Hulumtimi kuantitativ është zbatuar duke kryer **intervista ballë për ballë**, me stilolaps dhe letër. Teknikat e mostrës së anketës ka shfrytëzuar të dhëna primare. Procedura totale e mbledhjes së të dhënave ka përfshirë një mostër prej 499 intervistave.

Numri i anketave që janë plotësuar nga anketuesit është i ndarë nëpër lagje dhe në qendër të Prizrenit.

- Lagje 246 anketa
- Qendër 253 anketa

**Tabela 1.1: Ndarja e të anketave sipas lagjeve**

Nr.	Lagjja	Nr. i të anketuarve
1	Qendra e Prizrenit	253
2	Lagjja Bajram Curri	27
3	Lagjja Arbana	27
4	Lagjja Tabakhane	37
5	Lagjja Bazhdarhane	27
6	Lagjja Dardania	29
7	Lagjja Nën kalaja	17
8	Lagjja Qyk Mahalla	29
9	Lagjja Ortakoll	28
10	Lagjja Tusuzi	25

<b>Totali:</b>	<b>499</b>
----------------	------------

### Forma e përzgjedhjes së të anketuarve

Mënyra e përzgjedhjes së të anketuarve është bërë sipas mostrës me përzgjedhje të rastësishme, ku në secilën lagje, secili banor i cili i përket moshës përkatëse do të ketë të drejtë të marrë pjesë në hulumtim.

Hapi i parë në këtë metodë ka qenë zgjedhja e lagjeve, të cilat në rastin tonë janë të paraqitura në tabelën 1.1. Pasi janë zgjedhur mostrat (Lagjet), hapi ka qenë identifikimi i rrugëve në lagjet ku janë kryer intervistat.

Për shembull, nëse marrim lagjen Bajram Curri, apo qendrën e Prizrenit si një kornizë mostër, gjë tjetër para se të kryejnë intervistën do të jetë identifikimi i të gjitha rrugëve që do të mbulohen në hulumtim. Do të jetë një ndarje e barabartë në të gjitha rrugët e qytetit për të mbuluar gjithë komunën dhe si rezultat i kësaj, të dhënat janë më të sakta dhe të paanshme.

Pasi që përzgjedhja e rrugëve është bërë, atëherë ne kemi zgjidhur një pikë fillestare, e cila zakonisht ka qenë një vend i njohur në lagje, apo qendra të qytetit (p.sh. Shadërvani).

Nga kjo pikënisje, atëherë mbledhësit e të dhënave kanë zgjedh një drejtim për të kryer hulumtime dhe gjithmonë është ndjekur i njëjti sistem. Bazuar në rrugë të zgjedhura dhe numri i të anketuarve që janë në shënjestër për atë lagje (ku në rastin tonë janë përafërsisht 20 anketa në secilën lagje, nga gjithsej 9 lagje, dhe 253 në qendër të qytetit).

Mbledhësit e të dhënave kanë zgjedhur sistematikisht çdo të 4-tën shtëpi për t'u intervistuar. Ky proces sistematik është ndjekur për çdo rrugë/lagje. Në çdo shtëpi, mbledhësit e

të dhënave e kanë intervistuar personin më të vjetër se 18 vjet. Përzgjedhja e të anketuarve nga familjet është bërë bazuar në datën e tyre të lindjes, që do të thotë se personi ditëlindja e të cilit është më afër muajit shkurt është përzgjedhur për plotësimin e pyetësorit. Në këtë mënyrë, secili anketues ka pasur mundësi të barabartë për t'u zgjedhur.

Kjo metodë e hulumtimit ka dëshmuar mbledhje të sakta të të dhënave. Zakonisht, margjina e gabimit në këtë strategji është shumë e vogël, nga 2.0% deri në 2.5% (maksimum). Arsyet për këtë janë për shkak se mundësia e zgjedhjes së një popullsie që përfaqëson përbërjen demografike të vendit është më e lartë, duke pasur parasysh se secili anketues do të kenë një mundësi të barabartë për të qenë i përzgjedhur.

### Realizimi i Fokus Grupit

Pjesë e implementimit të hulumtimit ka qenë edhe organizimi dhe zhvillimi i një fokus grupi.

Qëllimi i diskutimit në fokus grup ka qenë të kuptohen perspektivat e segmentit përkatës të qytetarëve për temën “Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”.

Diskutimet kanë ndikim në raportin e analizës së të dhënave, sepse paraqiten informacione të dorës së parë nga persona të cilët janë të prekur drejtpërdrejt nga kjo situatë.

Fokus grupi është organizuar në muajin nëntor 2015. Në fokus grup kanë marrë pjesë 11 pjesëmarrës, të cilët kanë qenë përfaqësues të lagjeve me të cilat EC Ma Ndryshe bashkëpunon, dhe ata kanë dhënë mendimet e tyre rreth çështjes së urbanizimit në lagjet e tyre. Fokus grupi ka zgjatur rreth 1 orë e 40 minuta dhe është mbajtur në Prizren.


## V. Rezultatet

Rezultatet e nxjerra nga mostra e hulumtimit, përfshijnë mendimin e qytetarëve të Prizrenit, rreth pyetjeve të cilave ne u kemi bërë përmes pyetësorit të përgatitur nga EC Ma Ndryshe në bashkëpunim me GC&DA. Kjo mostër e përfshin një numër me 499 të anketuar në nëntë lagje dhe në qendrën e Prizrenit. Rezultatet e hulumtimit aktual do të komplementohen me rezultatet e 3 hulumtimeve të mëparshme të realizuara në gjatë tri viteve të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi urban për qytetarët”. Në hulumtimin e parë të kryer në prill të vitit 2013 kanë qenë të përfshirë 249 respondentë. Në hulumtimin e dytë të kryer në shtator të vitit 2013 kanë qenë të përfshirë 250 respondentë. Ndërsa në hulumtimin e tretë të kryer në qershor të vitit 2014, në anketim janë përfshirë 400 respondentë.

### Informatat demografike


Përbërja e mostrës së hulumtimit përfshin 67% (336) të respondentëve të gjinisë mashkullore dhe 33% (158) të gjinisë femërore.

Fig. 1.1: Gjinia



Mosha e respondentëve është e ndarë në 3 grupe. 29% (144) të respondentëve i përkasin grup moshës prej 16-25 vjeç; 65% (318) i përkasin grup moshës prej 26-64 vjeç, dhe grupi i fundit janë personat me mbi 65 vjeç dhe përqindja e tyre në këtë anketë është 6% (30).


Fig 1.2: Grupmoshat e participantëve



### Edukimi

Kryesisht respondentë të cilët kanë marrë pjesë në anketë kanë të mbaruar shkollën e mesme, dhe ky numër përfshin 31% të popullatës së anketës. Ndërsa 18% (90) e tyre kanë përfunduar nivelin universitar dhe janë të diplomuar dhe vetëm 1% (3) respondentë nuk kanë arsim formal.


Fig 1.3: Niveli i arsimit të participantëve



### Statusi i punësimit

Sa i përket nivelit të punësimit të respondentëve nga 499 respondentë 482 prej tyre e kanë deklaruar statusin e tyre. Nga kjo shifër 30% (147) e tyre janë të pa punë, 47% (226) janë të punësuar dhe 23% (109) janë studentë.



**Fig. 1.4: Statusi i punësimit i respondentëve**

### Rezultatet nga pyetjet profesionale të nxjerra nga pyetësi

Sipas rezultateve të nxjerra nga hulumtimi shihet se 58% (288) të respondentëve nuk kanë njohuri/informatë nëse qyteti i Prizrenit ka plan urban, ndërsa 42% (211) prej tyre kanë njohuri.

#### Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë (prill 2013) 62.7% të respondentëve kanë deklaruar se kanë njohuri/informatë se qyteti i Prizrenit ka plan urban.

Në hulumtimin e dytë (shtator 2013) 64.3% kanë raportuar se kanë njohuri se qyteti i Prizrenit ka plan urban.

Ndërsa, në hulumtimin e 3 (tetor 2014) 50.3% e respondentëve kanë deklaruar se kanë njohuri/informatë se qyteti i Prizrenit ka plan urban.


Nga 42% të cilët kanë informata rreth planit urban të komunës së Prizrenit, prej tyre 70% (147) këtë informatë e kanë marrë nga mediet (TV apo shtypi), ndërsa 18% prej tyre informatën e kanë marrë nga të afërmit.

#### Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë nga 155 (62.2%) respondentë që kanë deklaruar se kanë njohuri për atë se Prizreni ka plan urban 69% kanë dëgjuar për planin urban nga mediet, 18.7% nga të afërmit dhe 12.3% nga të tjerët.


Në hulumtimin e dytë nga 157 (67.9%) respondentë kanë deklaruar se informatën për ekzistimin e planit urban të Prizrenit e kanë marrë nga mediet 77.1%, nga të afërmit 12.1 dhe të tjerët 10.8%.

Ndërsa në hulumtimin e tretë nga 151, (50.3%) respondentë kanë deklaruar se kanë njohuri se Prizreni ka plan urbanistik, 35.0% e tyre kanë dëgjuar nga mediet, 10.3% nga të afërmit si dhe 4.0% nga të tjerët.

**Fig 1.5: Nga e keni marrë këtë informatë?**


Sa i përket pyetjes se sa janë qytetarët të informuar nëse ata mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve të ndryshme komunale, 33% (163) janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 67% (336) janë përgjigjur se nuk kanë informatë.

**Fig. 1.6: A keni njohuri nëse qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve urbane komunale?**



Vlera të ngjashme janë edhe me pyetjen se sa janë qytetarët e informuar se ata mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve të ndryshme në lagjet e tyre, rezultatet tregojnë që 30% e respondentëve e kanë këtë informata, ndërsa 70% e tyre nuk e kanë; 17 prej respondentëve nuk janë përgjigjur fare në këtë pyetje.

**Fig. 1.7: A keni njohuri nëse qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve urbane në lagje?**



#### Krahasimi me anketimet e mëhershme


Në hulumtimin e parë meshkujt kanë raportuar se me përqindje më të lartë se kanë informata se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin me 50.5% ndërsa vetëm 1/3 e femrave kanë raportuar se kanë informata për këtë çështje.

Në hulumtimin e dytë, siç mund të shihet edhe nga figura e mësipërme, ka një rritje të ndjeshme të femrave që kanë raportuar se kanë informata se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin më saktësisht 69.6% dhe meshkujt me 69.3%.

Në hulumtimin e tretë meshkujt kanë raportuar në përqindje më të lartë se kanë informata se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në përqindje prej 39.3%, ndërsa nga ana tjetër 31.7% e femrave kanë raportuar se kanë informata në lidhje me këtë çështje.


Kur bëhet fjalë se a kanë parë qytetarët në qytet ftesa apo thirrje për debate publike nga komuna, 62% (283) e tyre janë përgjigjur me PO, ndërsa 38% (176) me JO.

**Fig. 1.8: A keni parë në qytet ftesa/thirrje për debate publike nga komuna?**




Kur qytetarët janë pyetur për të njëjtën pyetje vetëm se lokacioni ka qenë në lagjet e tyre atëherë numri i përgjigjeve pozitive është zvogëluar krahas përgjigjes më sipër dhe 73% (333) janë përgjigjur negativisht, ndërsa 27% (126) që kanë parë ftesa në lagjet e tyre.

**Fig. 1.9: A keni parë në lagje ftesa/thirrje për debate publike nga komuna?**



Ndërsa kur qytetarët janë pyetur nëse ata kanë njohuri se komuna organizon debate publike para aprovimit të planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin, 70% (321) janë përgjigjur që nuk kanë njohuri, ndërsa vetëm 30% (137) e tyre kanë informatë në këtë drejtim.

**Fig. 1.10: A jeni të informuar se komuna organizon debate publike para aprovimit të planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin?**



Kryesisht e njëjta përgjigje është marrë edhe kur qytetarët janë pyetur nëse kanë njohur kur komuna organizon debate publike në lagje dhe numri i atyre që kanë qenë të informuar është vetëm 20% (90) e tyre.

Nga 30% e tyre që janë përgjigjur me PO, 94% e tyre nuk kanë marrë pjesë në debate publike, ndërsa vetëm 6% e tyre kanë marrë pjesë në debate publike dhe temat për të cilat ata kanë

marrë pjesë kryesisht kanë qenë çështjet rrugore/asfaltimi, ekonomike, ndriçimi publik, etj.

Kur bëhet fjalë nëse qytetarët kanë njohuri për planet rregulluese në lagjet e tyre dhe se a kanë qenë ndonjëherë të ftuar, 92% e tyre janë përgjigjur negativisht dhe vetëm 8% e tyre kanë qenë pjesë e planeve rregulluese.

#### Krahasimi me anketimet e mëparshme


Në hulumtimin e parë nga përqindja e qytetarëve që kanë deklaruar se janë në dijeni se komuna organizon debate publike vetëm 7.6% të tyre kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në ndonjëherë prej tyre.

Në hulumtimin e dytë nga përqindja e qytetarëve që kanë thënë se kanë njohuri se komuna organizon debate publike vetëm 12.6% kanë thënë se kanë marrë pjesë në ndonjëherë prej tyre. Nga debatet janë përmendur këto: në kuvend komunal; në lagje, në shtëpi të kulturës, me organizatën Ec ma Ndryshe, për qendrën e qytetit në shtëpi të kulturës, për rregullimin e një banese dhe një për qendrën sportive.

Në hulumtimin e tretë, nga përqindja e përgjithshme prej personave që kanë njohuri për organizimin e debateve publike, vetëm 1.3% kanë deklaruar që kanë marrë pjesë, 38.3% kanë raportuar që nuk kanë marrë pjesë si dhe 60.3% kanë qenë pa përgjigje (në këtë përqindje përfshihen edhe ata që kanë thënë se nuk kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin).


Sa i përket problemeve me të cilat qytetarët e Prizrenit janë duke u ballafaquar, 6 problemet kryesore, për të cilat janë duke i shqetësuar qytetarët janë: Rruga, uji, mbeturinat, parkingu, kanalizimi, dhe rryma.

**Fig: 1.11: Problemet kryesore të qytetarëve**



Se si qytetarët i artikulojnë nevojat e tyre në raport me organet komunale, 57% e qytetarëve i kontaktojnë vetë organet komunale, 13% e tyre i kontaktojnë përmes organizatave të ndryshme, dhe 8% nuk kanë ndonjë ide se si t'i artikulojnë nevojat e tyre në raport me organet komunale.

**Fig: 1.12: Si i artikulonin ju nevojat e juaja në raport me organet komunale?**



#### Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë shumica e respondentëve apo 61% kanë thënë se personalisht kontaktojnë me organet komunale, 30% të respondentëve kanë deklaruar se nuk e dinë se si mund t'i artikulojnë nevojat e tyre dhe vetëm 6% kanë thënë se këtë e bëjnë përmes shoqatave dhe organizatave të ndryshme. Ndërsa forma të tjera të komunikimit me 3.6% kanë qenë përmes familjarëve, 4 kanë thënë se nuk komunikojnë fare për shkak të mungesës së besimit, organet


gjyqësore, përmes kryetarit të lagjes, dhe petitionin.

Në hulumtimin e dytë ka një rritje të përqindjes së qytetarëve që deklarojnë se vetë i artikulojnë nevojat e tyre në komunë 72.3% dhe ka një rënie të përqindjes së qytetarëve që deklarojnë se nuk dinë si t'i artikulojnë nevojat e tyre nga 30% në hulumtimin e parë në 21.3% në hulumtimin e dytë dhe 4.4% kanë raportuar se e bëjnë përmes shoqatave dhe organizatave të ndryshme.

Në hulumtimin e tretë pjesa më e madhe e respondentëve apo 61.7% kanë thënë se personalisht kontaktojnë me organet komunale, 7.7% kanë thënë se këtë e bëjnë përmes shoqatave dhe organizatave të ndryshme, 4.7% e tyre nuk e din se si t'i artikulojnë nevojat që i kanë, si dhe 4.0% e tyre kanë forma të tjera të komunikimit me organet komunale.

Sa i përket pjesëmarrës së qytetarëve në debate publike të cilët kanë qenë të ftuar nga organet komunale 82% (410) prej tyre nuk kanë qenë të ftuar në debate publike dhe 18% kanë qenë të ftuara në këto debate. Nga kjo shifër, respondentët kanë deklaruar se 47% kanë marrë pjesë në debat dhe 53% nuk kanë marrë pjesë në debat edhe pse kanë qenë të ftuar.

**Fig. 1.13: A jeni ftuar në ndonjë debat publik nga organet komunale në lidhje me ndonjë çështje të caktuar?**



### Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë vetëm 15.7% të qytetarëve kanë deklaruar se kanë marrë ftesë nga organet komunale për debate publike për çështje të ndryshme të qytetit. Rezultate të ngjashme janë gjetur edhe në hulumtimin e dytë ku 14.7% e qytetarëve kanë deklaruar se janë ftuar në debate publike të organizuar nga komuna.


Nga 15.7% të qytetarëve që kanë marrë ftesë për debate nga komuna në hulumtimin e parë vetëm 1/4 e tyre kanë marrë pjesë në takimet në të cilat janë ftuar. Nga 10 qytetarë që kanë marrë pjesë në takime i kanë cekur këto takime: për arsim, për komunitetin RAE, për menaxhim të mbeturinave, për rregullimin e pronave, për rregullimin e lagjes, për rrugën e farkëtarëve, për të drejtat e grave dhe dhunën në familje. Në hulumtimin e dytë nga 14.7% të qytetarëve që kanë deklaruar se kanë marrë ftesë për të marrë pjesë në debate publike vetëm 14% të tyre u janë përgjigjur ftesave dhe 86% të ftuarve nuk kanë marrë pjesë në hulumtime.

Në hulumtimin e tretë, në pyetjen se a kanë qenë të ftuar në ndonjë debat publik, 11.0% e popullatës kanë marrë ftesë nga organet komunale, për dallim nga 87.3% e tyre që nuk kanë qenë të ftuar. Nga ata që kanë marrë ftesë vetëm 5.0% e tyre kanë marrë pjesë në takimet për të cilat janë ftuar. Nga popullata e përgjithshme, personat të cilët kanë marrë pjesë nëpër debate publike kanë biseduar për çështjet të ndryshme siç janë: ambienti, hartimi i planit të ri urbanistik, kanalizimi dhe asfaltimi i lagjes, projektet e Kryqit të kuq për Prizren, për banesat e lagjes si dhe për rregullimin e planit hapësinor.

Kur qytetarët janë pyetur për të njëjtën pyetje vetëm se në këtë rast ftesën e kanë bërë

organizatat, atëherë 86% e qytetarëve janë përgjigjur negativisht dhe 14% e tyre kanë deklaruar se janë ftuar në debate publike nga organizatat. Nga ky grup, 48% (33) e tyre kanë marrë pjesë në debat dhe 52% nuk kanë marrë pjesë në debat publik.

**Fig. 1.14: A jeni ftuar në ndonjë debat publik nga organizatat në lidhje me ndonjë çështje të caktuar?**



### Krahasimi me anketimet e mëhershme


Në hulumtimin e parë 13.7% të qytetarëve kanë deklaruar se janë ftuar nga OJQ, apo shoqëria civile për ndonjë debat të caktuar. Nga ata që kanë marrë ftesë për debat publik nga OJQ 41.2% kanë theksuar se kanë marrë pjesë në takimet që janë ftuar nga shoqëria civile apo OJQ-të dhe 58.8% kanë thënë se nuk kanë marrë pjesë. Nga ata që kanë cekur llojin e takimit vetëm katër kanë qenë të ndërlidhur me planin urban apo me planifikimin urban.

Në hulumtimin e dytë vetëm 8.2% të popullatës kanë deklaruar se kanë qenë të ftuar në ndonjë debat publik nga shoqëria civile/OJQ në lidhje me çështje të caktuara. Nga 21 apo 8.2% të respondentëve që kanë marrë ftesë vetëm 6 prej tyre apo 28.6% që kanë marrë ftesë u janë përgjigjur këtyre ftesave me pjesëmarrje. Për temat e shqyrtuara në takim janë përmendur këto: në kryq të kuq për çështje humanitare, nga enti për punësim, nga KDI, nga Save the Children dhe në lidhje me urbanizëm.

Në hulumtimin e tretë respondentët kanë deklaruar me një përqindje prej 19.30 % që janë ftuar për të marrë pjesë në debate të organizuara nga OJQ apo shoqëria civile për ndonjë debat të caktuar. Nga ata që kanë marrë pjesë 10.7% e tyre kanë marrë pjesë në takimet për të cilat janë thirrur. Nga organizatat që kanë marrë pjesë në debate publike, çështjet të cilat janë diskutuar janë si: infrastruktura, buxheti për persona me aftësi të kufizuara, për planet e veprimt për romët, për planifikim të buxhetit, kornizat afatmesme të buxhetit, për arsim/edukim, për ndriçimin publik, për planifikimin urbanistik, për raste sociale, për rregullimin e qytetit, për varrezat - kompleksi Landovicë, rregullimi i shkallëve në Kala, rregullimi i ndërtesës së Lidhjes së Prizrenit, rregullorja për vullnetarizëm, për sportin, për të drejtat e grave dhe barazi gjinore, si dhe për trashëgiminë kulturore.

Sa i përket bashkëpunimit të qytetarëve në iniciimin e nismave të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në lagjet e tyre, respondentët kanë deklaruar se 32% (159) kanë qenë pjesë e iniciativave për të bërë ndryshime në lagjet e tyre, ndërsa 68% (431) nuk e kanë bërë këtë.


**Fig. 1.15: A keni provuar personalisht apo në grup me qytetarët tjerë që të inicioni ndonjë nismë për zgjidhjen e ndonjë problemi në lagjen/mëhallën tuaj gjatë viteve të fundit?**



Prej 32% të respondentëve të cilët kanë filluar nisma të ndryshme, kryesisht shkresa/kërkesa në drejtim të komunës për të përmirësuar çështje të caktuara, ankesa në drejtim të komunës, etj, prej tyre vetëm 71 persona i janë përgjigjur pyetjes se cili ka qenë reagimi i komunës, a është ndërmarrë ndonjë masë, dhe a është zgjidhur problemi përfundimisht, përgjigjet janë: 48 prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë pas ndonjë reagim nga komuna, dhe 62 prej tyre kanë deklaruar se nuk është ndërmarrë asnjë masë në atë drejtim; ndërsa sa i përket zgjidhjes së problemit, 23 persona kanë deklaruar që problemi nuk është zgjidhur përfundimisht ndërsa 16 kanë deklaruar që problemi në lagjen e tyre është zgjidhur.

Kur qytetarët janë pyetur nëse kanë pas ndonjë mundësi që problemet e tyre t'i artikulojnë dhe paraqesin para kryetarit të komunës, 91 % (454) e tyre kurrë nuk kanë pasur rastin t'i paraqesin problemet e tyre para kryetarit ndërsa vetëm 9% (45) e tyre kanë deklaruar pozitivisht.


**Fig. 1.16: A keni pasur ndonjë mundësi që problemet aktuale ti paraqitni para kryetarit të komunës?**



Sa i përket organizimit/këshillimit lokal në lagje, 68% (339) e qytetarëve janë përgjigjur se nuk ekziston një formë e organizimit lokal dhe 32% (160) e tyre kanë thënë se ekziston. Ata gjithashtu kanë deklaruar se vendet ku ata zakonisht takohen për diskutimin e çështjeve që

kanë të bëjnë me lagjet e tyre janë: lokalet afër lagjes, shkollat, çajtoret, por gjithashtu takimet bëhen edhe në rrugë/mëhallë.


**Fig. 1.17: A ekziston ndonjë formë e organizimit/këshillimit lokal në lagjen tuaj?**



Ndërsa kur qytetarët janë pyetur nëse komuna inkurajon funksionimin e këshillave lokale në lagje, 80% (397) e tyre kanë deklaruar se komuna nuk i inkurajon këto organizime ndërsa vetëm 20% (102) e tyre kanë thënë që po.

Sa i përket shfrytëzimit të hapësirave publike në lagje qytetarët kanë deklaruar se në 65% të rasteve ata nuk i shfrytëzojnë hapësirat publike, dhe 35% i shfrytëzojnë.

**Fig. 1.18: A i shfrytëzoni dhe si i shfrytëzoni hapësirat publike në lagjen tuaj?**




Shfrytëzimi i hapësirave publike kryesisht është bërë për ecje, shfrytëzimi i parkut dhe sport.

Përqindja e qytetarëve të cilët janë aktiv, të angazhuar në organizata të ndryshme është 4%, ndërsa 6% e tyre kanë deklaruar se kanë qenë

të angazhuar në organizata mirëpo më nuk vazhdojnë të jenë, dhe 90% kanë deklaruar se nuk i takojnë asnjë organizate.

**Fig. 1.19: Përqindja e qytetarëve që janë pjesë në organizata të ndryshme**



#### Krahasimi me anketimet e mëparshme

Nga hulumtimi i parë del se:

- 4.8% e qytetarëve aktivë janë në parti politike,
- 4.4% në organizata e artit, kulturës dhe arsimit dhe
- 4.3% në organizata fetare.

Në hulumtimin e dytë, përqindja më e madhe e qytetarëve aktivë në organizata kanë rezultuar të jenë:

- sindikatat me 6.4% anëtarë aktiv,
- organizatat sportive - rekreative me 5.6% anëtarë aktivë
- parti politike me 3.2% si anëtarë aktiv.


Në hulumtimin e tretë përqindja më e madhe e qytetarëve aktiv në organizata ka rezultuar të jetë kështu:

- parti politike me 10%,
- organizatat sportive dhe rekreative me 8.0%
- organizatat e artit, kulturës dhe arsimit me 7.0%,
- 6.7% organizata fetare.

Kur qytetarët janë pyetur se a kanë nënshkruar ndonjëherë peticion 55% e tyre kanë deklaruar se kanë nënshkruar, 29% kanë thënë se ndoshta do ta bënin, ndërsa 16% prej tyre kanë deklaruar se nuk do ta bënin fare.

Sa i përket bashkëngjitjes në bojkot, 24% kanë deklaruar se e kanë bërë, 48% se ndoshta do ta bënin, dhe 28% qe nuk do ta bënin asnjëherë. Gjithashtu, edhe ne pyetjen për pjesëmarrje në demonstrata paqësore, rezultatet janë respektivisht 39%, 34%, dhe 27%.

**Fig. 1.20: Pjesëmarrje e qytetarëve në nënshkrimin e peticioneve, bashkëngjitjes në bojkot, dhe pjesëmarrja në demonstrata paqësore**




#### Pyetje për të gjithë të intervistuarit

Pjesë e hulumtimit kanë qenë edhe disa pyetje gjithëpërfshirëse, objektive e të cilave kanë

qenë disa nga çështjet urbanistike të komunës së Prizrenit. Në këtë pjesë, qytetarëve u është kërkuar të zgjedhin 4 nga problemet më të rëndësishme, të cilat duhet të adresohen nga organet komunale.

**Fig. 1.21: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 4 çështje që janë më të rëndësishme që duhet të kenë një adresim nga organet komunale:**



Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga qytetarët janë:

1. Zënia e trotuareve me makina - 19%
2. Mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet – 15%
3. Mungesa e parqeve publike – 11%
4. Ndërtimet pa leje – 9%
5. Mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve – 8%

Tek çështja e parë e cila ka numrin më të madh të ankesave, “zënia e trotuareve” qytetarë në 86% (327) janë përgjigjur se janë zënë nga



makinat, ndërsa me vlera më të vogla ata kanë deklaruar se trotuaret janë zënë nga shitoret me 4%, shitësit ambulante me 4% dhe me gjëra tjera 5%.

#### Krahasimi me anketimet e mëhershme


Në hulumtimin e parë qytetarëve ju janë parashtruar 20 çështje të ndryshme të urbanizmit dhe të qytetit dhe ju është kërkuar që ata ti zgjedhin 4 çështje që duhet të kenë një adresim më serioz nga organet komunale. Analiza është bërë për të gjitha opsionet nëse është përmendur si çështje nga qytetarët e intervistuar. Çështje që u përmendën nga 63.1% e të anketuarve ishte bllokimi i trotuareve me makina, e dyta ishte mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 42.6%, 35% ndërtimet pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara 29% si e katërta, e pesta qarkullimi i vështirësuar për persona me aftësi të kufizuara, e gjashta problemet me ujësjellës dhe e shtata ndërtimet e larta.

Në hulumtimin e dytë në çështjet e ndërlidhura me urbanizëm u shtua çështja e ndërtimeve pa leje dhe shkatërrimi i qendrës historike. Sikurse në hulumtimin e parë intervistuesit i kërkuan respondentëve të identifikojnë katër çështjet kryesore që janë brengosëse për ta. Analiza e të dhënave tregon se katër çështje kryesore për qytetarë të Prizrenit janë: Bllokimi i trotuareve me makina 64.3%, ndërtimet pa leje 44.6%, mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 41.8% dhe e katërta shkatërrimi i qendrës historike të Prizrenit me 35.3%. Është me rëndësi të theksohet se rezultatet e tjera siç janë p.sh. problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuara dhe mungesa e hapësirave të gjelbëruara janë paraqitur si

probleme edhe në hulumtimin e dytë dhe përqindjet janë të ngjashme.

Në hulumtimin e tretë, qytetarëve u janë parashtruar 20 çështje të ndryshme të urbanizmit dhe të qytetit të Prizrenit, ku iu është kërkuar që ti zgjedhin 4 opsione nga ato që sipas tyre janë më të rëndësishme për t'u adresuar. Analiza është bërë për të gjitha opsionet ku si problem i parë është paraqitur bllokimi i trotuareve me makina me një përqindje prej 72.4%, e përcjellë nga ndërtimet pa leje me 44%, më pas mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet me 42%, me 18.6% janë problemet me infrastrukturë (kanalizimi dhe ujësjellësi), mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve është e 18.3% si dhe çerdhet për fëmijë me 17.6%. Nëse krahasohen tri hulumtimet e para, del se problemi akut i qytetit të Prizrenit ishte bllokimi i trotuareve.

**Fig. 1.22: Problemet specifike që kanë të bëjnë me bllokimin e trotuareve:**



#### **Pyetje për pensionistët**

Pyetje të ngjashme janë parashtruar edhe për pensionistët nga komuna e Prizrenit. Pikëpamjet e tyre në raport me çështjet më problematike në lagjet e tyre tregojnë se çështja e bllokimit të trotuareve – 19% (20) gjithashtu edhe për pensionistët mbetet çështja më problematike.

Problemet tjera me të cilat pensionistët ballafaqohen janë mungesa e vend takimeve për pensionistët/hapësira rekreative ku 18% (19) e popullatës së mostrës e kanë zgjedhur këtë si çështje problematike.

Gjithashtu mungesa e hapësirave të gjelbra dhe parqeve publike janë çështje problematike për pensionistët.


#### Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë 12% e mostrës së përgjithshme ishin mbi moshën 65 vjeçare dhe këta respondentë përpos që u janë përgjigjur pyetjeve që janë raportuar më lartë atyre ju është kërkuar që nga një grup i çështjeve urbanistike të zgjedhin 3 çështje kryesore që janë më relevante për këtë grup moshë. 80% të respondentëve mbi moshën 65 vjeçare mendon se mungon hapësira e dedikuar për takimin e më të moshuarve si çështje të parë, 50% bllokimin e trotuareve dhe me nga 30% është mirëmbajtja e trotuareve gjatë dimrit dhe ndërtimet pa leje.

Në hulumtimin e dytë nga mostra që ishin pensionist mbi moshën 65 vjeçare dhe katër çështje kryesore sipas kësaj popullate janë: bllokimi i trotuareve me makina 69.7%, vend takim për pensionist/hapësira rekreative 51.5%, ndërtimet pa leje 42.4% dhe mungesa e hapësirave të gjelbëruara si çështje e katërt me 33.3%.

Në hulumtimin e tretë me një përqindje prej 76 % ishte mungesa e vend takimeve për pensionistët/ hapësira rekreative, e dyta me 44 % ishte bllokimi i trotuareve me makina si dhe e treta ishte qasja në institucionet shëndetësore me një përqindje prej 44%.

**Fig. 1.23: Nga lista e mëposhtme të çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 3 çështje që janë më të rëndësishmet që duhet të kenë një adresim nga organet komunale për ju dhe pensionistët e tjerë në Prizren:**




#### **Pyetje për gratë**

Gjithashtu edhe gjinia femërore ka qenë pjese e targetit për çështje të caktuara.

Nga grupi i grave, problemi i bllokimit të trotuareve gjithashtu vazhdon të mbetet një nga problemet kryesore. Mirëpo përveç kësaj mungesa e hapësirave të gjelbra së bashku me parqet publike janë 3 çështjet kryesore që gratë në komunën e Prizrenit i kanë.

1. Bllokimi i trotuareve – 21% (55)
2. Mungesa e hapësirave të gjelbra – 15% (39)
3. Mungesa e parqeve publike – 14% (38)

**Fig. 1.24: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 3 çështje që janë më të rëndësishmet që duhet të kenë një adresim nga organet komunale për ju dhe gratë tjera në Prizren:**




#### Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë si çështje që u përmend nga më shumë se gjysma e qytetarëve femra ishte 66% ishte bllokimi i trotuareve me makina, e dyta ishte mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 43.1%, 30.6% ndërtimet pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara 30.6% si e katërta, e pesta problemet për qarkullimin e qytetarëve me nevoja të veçanta, e gjashta mungesa e çerdheve për fëmijë ujësjellësi dhe e shtata ujësjellësi.

Në hulumtimin e dytë si çështje që u përmend nga më shumë se gjysma e qytetarëve femra ishte 58.5% ishte bllokimi i trotuareve me makina, e dyta ishte mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 50.4%, 40.6%

**Fig. 1.25: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 3 çështje që janë më të rëndësishmet që duhet të kenë një adresim nga organet komunale për ju dhe të rinjtë e tjerë në Prizren:**



ndërtimet pa leje, si e katërta problemet për qarkullimin e qytetarëve me nevoja të veçanta 34.8% dhe e pesta shkatërrimi i qendrës historike të Prizren.

Në hulumtimin e tretë, 57% e mostrës kanë qenë femra mbi moshën 16 vjeçare dhe në pyetjet e dedikuara për këtë mostër si çështje e parë është përmendur siguria në rrugë me 62%, e dyta bllokimi i trotuareve me makina 60% dhe me 35% mirëmbajtja e trotuareve gjatë dimrit.

#### **Pyetjet për të rinjtë**

Pjesë e hulumtimit ka qenë edhe mendimi i të rinjve të komunës dhe cilat janë 3 problemet kryesore urbanistike me të cilat ata ballafaqohen më së shumti, dhe gjithashtu edhe tek grupi i të rinjve problemi i bllokimit të trotuareve kryeson me 19% (129) të respondentëve. Mungesa e hapësirave të gjelbra dhe parqeve publike janë 2 çështje tjera me të cilat të rinjtë e Prizrenit ballafaqohen dhe rezultatet janë respektivisht 11% dhe 18%. Ndërsa çështja e mbingarkesës së shkollave me ndërrime ka rezultuar të jetë çështja më pak problematike me vetëm 2% (12) të respondentëve.

#### Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë 24.9% e mostrës kanë qenë të rinj nën moshën 26 vjeçare, si tre çështje kryesore të zgjedhur nga të rinjtë janë si vijon në figurën e mëposhtme. Si çështje kryesore që është përmendur janë mirëmbajtja e trotuareve gjatë dimrit, e dytë bllokimi i makinave me trotuare me 43.5% dhe e treta mungesa e hapësirave funksionale me teatër/kinema e përcjellë me të katërtën mungesën e hapësirave rekreative.

Në hulumtimin e dytë si çështje e parë u përmend bllokimi i trotuareve me makina me


42%, ndërtimet pa leje 39.5% si e dytë, mungesave e hapësirave kulturore dhe rekreative me 32.1% dhe e katërta mungesa e hapësirave të gjelbëruara.

Në hulumtimin e tretë Të rinjtë nga mostra e përgjithshme me pyetje të veçanta duhet të zgjidhnin 3 çështje kryesore si më problematike për ta. E para radhitet mungesa e hapësirave rekreative - 48.4%, e përcjellë nga bllokimi i trotuareve me makina me 41.8 % si dhe e treta është mungesa e hapësirave kulturore për koncert/kinema me 35.2%.

### Pyetje për persona me nevoja të veçanta

Sa i përket personave me nevoja të veçanta 3 çështjet më problematike janë: bllokimi i trotuareve me makina me 27%, mungesa e ndriçimit publik me 20%, problemet në banesa kolektive me 13%, dhe mungesa e qasjes në transportin publik për persona me aftësi të kufizuara me 7%.

**Fig. 1.26: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 3 çështje që janë më të rëndësishmet që duhet të kenë një adresim nga organet komunale për ju dhe PNV-të e tjerë në Prizren:**



### Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë, në total 7 organizata janë intervistuar dhe problemet kryesore të raportuara nga këto organizata ka qenë si vijon:

- 71.4% thonë se problem i rëndësishëm mungesa e qasjes së personave me nevoja të veçanta në transportin publik,
- 71.4% mungesa e pjerrinave për qasje në institucione publike,
- 42.9% mungesa e shenjzimeve për persona të verbër,
- bllokimi i trotuareve me 28.6%.

Në hulumtimin e tretë sipas përfaqësuesve nga organizatat për persona me nevoja të veçanta, të cilët u intervistuan (23 prej tyre), rezultuan 4 çështjet kryesore, të cilat radhiten si vijon:


- 66.7% - bllokimi i trotuareve me makina,
- 33.4% - mungesa e lidhjeve të transportit publik,
- 33.9% - mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve, dhe
- 33.9% problemet e qarkullimit për persona me nevoja të veçanta.

### Pyetje të drejtuara për përfaqësuesit e organizatave në qytetin e Prizrenit

Edhe përfaqësuesit e organizatave kanë qenë pjesë e targetit të hulumtimit. Kur përfaqësuesit e organizatave janë pyetur se cilat janë 3 problemet kryesore të cilat i shqetësojnë, ata janë përgjigjur:

1. Bllokimi i trotuareve me makina – 11%
2. Mungesa e hapësirave të gjelbra – 9%
3. Mungesa me ndriçim publik – 9%
4. Ndërtimet pa leje – 9%
5. Probleme me higjienën në banesa kolektive – 7%
6. Mungesa e parqeve publike – 7%
7. Mungesa e hapësirave kulturore për koncerte/kinema – 7%

**Fig. 1.27: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 3 çështje që janë më të rëndësishmet që duhet të kenë një adresim nga organet komunale për ju dhe organizatat tjera në Prizren:**



#### Krahasimi me anketimet e mëhershme

Nga 242 respondentë përfaqësues të organizatave të ndryshme, përfitues të skemave sociale, të rinj të punësuar dhe të papunësuar, gra të punësuar të papunësuar dhe pensionist ka rezultuar se pesë çështje kryesore për ta janë si vijon:

- 65.7% bllokimi i trotuareve me makina,
- 4.5% ndërtimet pa leje,
- 43% problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuar,
- 38.4% mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit dhe
- 29% ndërtimet e larta në qytet.

Nga 250 respondentë në hulumtimin e dytë përfaqësues të organizatave të ndryshme, përfitues të skemave sociale, të rinj të punësuar dhe të papunësuar, gra të punësuar të papunësuar dhe pensionist ka rezultuar se pesë çështje kryesore për ta janë si vijon:

- 60% bllokimi i trotuareve me makina,
- 49.2% ndërtimet pa leje,
- 42.8% problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuar,
- 40.8% shkatërrimi i qendrës historike të Prizrenit,

- 32.4% mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit
- 29% ndërtimet e larta në qytet.

Në hulumtimin e tretë si çështje kryesore me këtë popullatë u identifikua të jetë:

- 48.1% ndotja e mjedisit (ajri dhe lumi),
- 46.1% shkatërrimi i qendrës historike
- 33.5% mungesa e një plani të qëndrueshëm për zhvillim mjedisor
- 32.9% bllokimi i trotuareve me makina.

#### **Niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me çështje të ndryshme**

Kur bëhet fjalë për nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me çështje të ndryshme ata janë kërkuar që ti vlerësojnë ato nga 1 deri në 10 (numri 1 bën vlerësim shumë të dobët, ndërsa numri 10 vlerësim shumë të mirë) qytetarët janë shprehur sipas të dhënave më poshtë:

- Hapësira të gjelbëruara në qytet – 19% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- Mirëmbajtja e ashensorëve në ndërtesa kolektive – 26% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- Korsitë/shtigjet për biçikleta – 59% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- Numri i parqeve publike – 23% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1
- Mirëmbajtja e trotuareve për parkim – 40% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- Mirëmbajtja e rrugëve – 57 % e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-5.
- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë dimrit – 28% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- Numri i çerdheve për fëmijë – 57% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-5.
- Sistemi i edukimit – 60% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-5.
- Ndriçimi publik – 57 % e qytetarëve e kanë vlerësuar me nga 5-10.
- Lidhjet e transportit publik – 59% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 5-10.

- I. Numri i hapësirave rekreative – 18% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- II. Numri i hapësirave kulturore koncerte/kinema – 20% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- m. Ndërtime pa leje – 45% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- n. Ndërtime të larta – 40% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- o. Me mundësinë e ofruar për qarkullim për persona me nevoja të veçanta (grupe të ndryshme) – 51 e qytetarëve e kanë vlerësuar me 1.
- p. Kanalizimi – 52% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-5.
- q. Furnizim me ujë – 28% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 10.
- r. Cilësia e ujit të pijshëm – 27% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 10.
- s. Vend takime/hapësirat për të moshuarit/pensionistët – 70% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-5.

#### Çështjet me vlerësimin më të dobët

Nga 20 çështjet e përshkruara më lartë, 5 me vlerësimin më të dobët janë:

1. Korsitë/shtigjet për biçikleta – 92% e kanë vlerësuar nga 1-5, ndërsa 59% e kanë vlerësuar me 1 (shumë dobët).
2. Mundësi e ofruar për qarkullim për persona me aftësi të kufizuara (grupe të ndryshme) 85% e kanë vlerësuar nga 1-5, ndërsa 51% e kanë vlerësuar me 1 (shumë dobët).
3. Ndërtime pa leje – 80% e kanë vlerësuar nga 1-5, ndërsa 45% e kanë vlerësuar me 1 (shumë dobët).
4. Ndërtime të larta në qytet - 75% e kanë vlerësuar nga 1-5, ndërsa 40% e kanë vlerësuar me 1 (shumë dobët).

5. Mirëmbajtja e trotuareve për parkim - 79% e kanë vlerësuar nga 1-5, ndërsa 40% e kanë vlerësuar me 1 (shumë dobët).

#### Çështjet me vlerësimet më të lartë

Nga çështjet e listuara 2 prej tyre kanë marrë vlerësimet më të larta, dhe ato janë:

1. Furnizim me ujë – 66% e kanë vlerësuar nga 5-10, ndërsa 28% e kanë vlerësuar me 10 (shumë mirë).
2. Cilësia e ujit të pijshëm – 66% e kanë vlerësuar nga 5-10, ndërsa 27% e kanë vlerësuar me 10 (shumë mirë).

#### Krahasimi me anketimet e mëhershme

*Në hulumtimin e parë niveli më i ultë i kënaqshmërisë është raportuar për atë se çka është bërë për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta, e dyta për qarkullimin për këmbësorë, e treta për hapësirat kulturore, e katërta qytetarët nuk janë të kënaqur me atë që është bërë për ndërtimet pa leje dhe e pesta me mesatare më të ultë të kënaqësisë është raportuar për mirëmbajtjen e trotuareve gjatë dimrit.*


*Në hulumtimin e dytë sikurse edhe në të parën më se paku qytetarët kanë qenë të kënaqur për atë se çka është bërë në lidhje me rregullimin e problemeve që kanë të bëjnë me qytetarët me nevoja të veçanta e pasuar nga ajo se çka është bërë lirim të trotuareve nga makinat, pastaj për ndërtimet pa leje dhe e katërta për atë se çka është bërë për mungesën e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit.*

*Në hulumtimin e tretë shihet se në niveli më i lartë i kënaqshmërisë lidhet me furnizimin me*

ujë 7.2%, e pasuar nga kanalizimi 6.8%, 6.6% me transportin publik, 6.6% me ndriçimin publik dhe 6% me mirëmbajtjen e rrugëve. Ndërsa niveli i ulët i kënaqshmërisë bie mbi çështjet si: ndërtimet pa leje 2.1%, mundësia e ofruar për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta 2.4%, ndërtimet e larta në qytet 2.8%, me mirëmbajtjen e trotuareve për parkim 2.8% dhe me 3.2% mirëmbajtjen e trotuareve gjatë dimrit.


Sa i përket pyetjes nëse qytetarët e përdorin transportin publik 53% (263) kanë deklaruar se nuk e përdorin transportin publik, ndërsa 47% (236) kanë thënë se e përdorin.

**Fig. 1.28: A e përdorni transportin publik në Prizren?**



Nga grupi i cili janë deklaruar se nuk e përdorin transportin publik 51% e tyre nuk e përdorin sepse kanë makina, ndërsa 30% kanë thënë se kanë dëshirë të ecin vetë.


**Fig. 1.29: Nëse Jo, cilat janë arsyet?**



Ndërsa pjesa tjetër që janë deklaruar pozitivisht, janë pyetur se sa shpesh përdorin transportin publik 47% e tyre kanë deklaruar që e përdorin

rrallë herë, ndërsa 33% kanë thënë se e përdorin shpesh apo pothuajse çdo ditë.

**Fig. 1.30: Nëse PO, sa shpesh e përdorni?**



### Rezultatet e nxjerra nga Fokus Grupi

Gjithashtu edhe nga fokus grupi çështjet që janë diskutuar kanë të bëjnë me çështjet e ngjashme që janë pyetur përmes pyetësorit.

Të pranishëm në diskutim kanë qenë 12 pjesëmarrës, prej tyre 4 nga gjinia femërore dhe 8 nga gjinia mashkullore. Secili pjesëmarrës ka përfaqësuar një lagje të caktuar në komunën e Prizrenit, lagjet të cilat kanë qenë edhe pjesë e hulumtimit në terren, përfshirë Lagjen Arbana, Ortakoll, Bazhdarhane, Qyk Mahallë, Tabakhane, dhe Qendër. Prezent në fokus grup kanë qenë edhe përfaqësues të organizatës OPDMK dhe KDI.

Takimi është mbajtur me datën 12 nëntor 2015, nga ora 18:00 deri në ora 19:30, në zyrën e OJQ-së EC Ma Ndryshe në Prizren.

Fokus grupi është moderuar nga një zyrtarë e kompanisë Global Consulting & Development Associates Sh.p.k. dhe një asistent.

### Tema e diskutimit

Tema e diskutimit të fokus grupit ka përmbledhur pyetjet të cilat kanë qenë të parashtruara në pyetësor dhe më gjerë.

Fillimisht participantët janë kërkuar që të prezantohen dhe të tregojnë se cilën lagje ata e përfaqësojnë.

Më pas është diskutuar direkt për çështjet urbanistike në lagjet e tyre, problemet me të cilat ato lagje janë duke u ballafaquar dhe raportet me komunën.

Diskutimin e kanë filluar participantët një nga një dhe në momentin e pare të diskutimit kemi hasur në problemin e ndërtimeve pa leje në komunën e Prizrenit dhe problemet tjera që po rrjedhin nga këto ndërtime pa leje siç janë:

- Parkingu
- Zënia e trotuareve
- Kanalizimi
- Mungesa e hapësirave të gjelbra
- Dëmtimi i monumenteve historike

Fillimisht, pjesëmarrësit janë pyetur nëse kanë njohuri se qyteti i Prizrenit ka plan urban dhe te gjithë prej tyre janë përgjigjur që po e kanë këtë informatë mirëpo problemi është se sa ai plan urban është duke u respektuar nga komuna dhe qytetarët e Prizrenit.

Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit janë shprehur se problemi kryesor që po ia pamundëson jetesën e rregullt në qytetin e tyre është problemi i ndërtimeve pa leje dhe problemet përcjellëse që rrjedhin si pasojë e atyre ndërtimeve.

Në rastin e përmendur në lagjen Tabakhane, përfaqësuesi i kësaj lagje ka shprehur shqetësimin e tij dhe të të gjithë banorëve të asaj lagje rreth ndërtimit të bibliotekës së qytetit në atë lagje. Arsyeja e shqetësimit është se me ndërtimin e atij objekti në hapësirën e lagjes Tabakhane, bëhet ngufatja e asaj lagje, rritet numri i makinave (edhe pse përfaqësuesi e ka cekur se edhe pa ndërtimin e saj parkingu është një problem shumë i madh në atë lagje) dhe dëmtohet infrastruktura rrugore e asaj lagje.

Përveç dëmtimit të infrastrukturës problemi më i madh është shkatërrimi i trashëgimisë kulturore të Kosovë. Në vendin ku dëshiron të ndërtohet biblioteka e qytetit, ajo gjendet në afërsi të një shkolle të vjetër, “Ruzhdija e Vjetër”, e cila daton që nga viti 1874 dhe për këtë arsye është e mbrojtur si trashëgimi kulturore nga Ministria e Kulturës së Republikës së Kosovës.

Zona ku kjo shkollë e vjetër është e ndërtuar sipas planit urbanistik të Prizrenit duhet të behet e tillë dhe nuk lejohen ndërtime të reja afër shkollës, mirëpo me ndërtimin e bibliotekës së re, ky plan urbanistik po ndryshohet dhe nuk po përfillet ajo çka është e mbrojtur edhe nga vetë ministria.

Me këtë rast qytetarët janë grumbulluar dhe përmes peticioneve dhe aktiviteteve tjera janë duke u munduar ta ndalin këtë veprim të komunës, mirëpo vazhdimisht po hasin në shumë vështirësi.

Për vendimin e ndërtimit të bibliotekës së re në asnjë rast nuk është organizuar asnjë debat publik, tryezë e rrumbullakët me qytetarët apo diçka e ngjashme dhe vetëm është vendosur nga ana e komunës për ndërtimin e kësaj biblioteke.

Ankesa e qytetarëve është të mos bëhet ndërtimi i bibliotekës në atë vend për shkak se:

- Dëmton dhe prish imazhin e trashëgimisë kulturore
- Rrit komunikacion rrugor në atë lagje dhe pamundëson qarkullimin e qytetarëve të cilët jetojnë në atë lagje

Qytetarët rekomandojnë që kjo bibliotekë të ndërtohet në ndonjë pjesë tjetër të qytetit.

Probleme të natyrës së ngjashme janë diskutuar edhe në lagjen Bazhdarhane (ndërtimi i objekteve të reja) të cilat gjithashtu dëmtojnë infrastrukturën (uji, kanalizimi, rruga) e atyre



lagjeve dhe gjithashtu zhdukin edhe ato pak hapësira të gjelbra të cilat i ka ajo lagje.

I njëjti problem është shfaqur edhe në lagjen Dardania, me ndërtimin e një objekti shumë katesh mirëpo në këtë rast me anë të iniciative të qytetarëve punimet janë ndalur.

Ankesat e qytetarëve dhe rekomandimet e tyre janë se në rastet kur bëhen ndryshime të planit urbanistik, fillimisht duhet të diskutohet me qytetarët dhe t'i pyesin edhe ata se cilat janë qëndrimet e tyre, gjithashtu kërkohet që para aprovimit të planeve të reja të formohen:

- Debate publike me qytetarët
- Tryeza të rrumbullakëta
- Konsultime me ekspert të çështjeve të caktuara
- Konsultime edhe me ministrin e Kulturës Rinisë dhe Sportit (siç është rasti i shkollës së vjetër)


Dhe vetë pasi të jenë përmbushur këto procedura të vazhdohet me ndryshimin e planeve urbanistike.

### **Përmbledhja e rezultateve nga anketimi dhe fokus grupi**


Sipas të dhënave të nxjerra nga hulumtimi dhe gjithashtu edhe nga Fokus Grupi shihet qartë se problemet kryesore të qytetarëve të komunës së Prizrenit janë duke u ballafaquar me probleme të shumta infrastrukturore.

Sipas statistikave të nxjerra ndërtimet pa leje, ndërtimet e larta, dhe mirëmbajtja e trotuareve, mungesa e shtigjeve për biçikleta dhe mundësi për qarkullim për persona me nevoja të veçanta janë 5 çështjet kryesore për të cilat duhet të intervenohet menjëherë.


Sipas vlerësimeve të qytetarëve 92% të anketuesve e kanë vlerësuar dobët problemin e korsive për biçikleta në komunën e tyre.




Gjithashtu 85% e tyre e kanë vlerësuar dobët mundësinë për qarkullim për persona me aftësi të kufizuara.



80% e tyre mendojnë se ndërtimet pa leje janë problem i madh në komunën e Prizrenit dhe 75% e tyre mendojnë se pjesë e këtyre ndërtimeve pa leje janë edhe objektet e larta të cilat janë duke u ndërtuar në lagjet e tyre.



Dhe së fundi afro 80% e qytetarëve janë të pajtimit se mirëmbajtja e trotuareve është çështje shumë problematike që duhet të zgjidhet menjëherë.



## VI. Konkludim

Në përgjithësi, rezultatet e anketimit të katërt, edhe në vitin e tretë të realizimit të tij, në kuadër të analizës për Qytetin gjithëpërfshirës, i konfirmojnë dhe i përforcojnë të gjeturat e analizave të kryera në vitin 2013 dhe 2014. Respondentët shprehen jashtëzakonisht të pakënaqur me menaxhimin e qytetit nga komuna e Prizrenit. Kjo është më se e evidente nga numërimi i brengave dhe problemet e mëdha të identifikuar dhe të ilustruara në grafikonet që përmbledhin rezultatet e anketimit të katërt.

Si probleme kritike vazhdojnë të jenë si vijon:

- Numri shumë i vogël i qytetarëve, që kanë informatë se mund të marrin pjesë të informuar për planet urbane dhe mundësinë e marrjes pjesë në hartimin e tyre;
- Qasja dhe lëvizja në qytet për të gjithë qytetarët pavarësisht moshës, gjinisë dhe aftësisë si pasojë e infrastrukturës së papërshtatshme apo edhe mirëmbajtjes së munguar të rrugëve;
- Degradimi i hapësirës urbane, qoftë me anë të ndërtimeve pa leje, apo edhe ndërtimeve të larta në zonën historike të qytetit;
- Mungesa e hapësirave publike, në veçanti ato të gjelbra, që do t’iu mundësonin qytetarëve të intervistuar nga grupe të ndryshme të interesit që ta shfrytëzonin në mënyrë më të efektshme qytetin dhe të kenë një jetë më cilësore në përgjithësi.
- Pamundësia e lëvizjes me biçikleta, i cili si problem u aktualizua sivjet.

## 1. Ndërtimi i qytetarisë aktive

Nga anketimi, shihet se gjysma e qytetarëve të Prizrenit nuk kanë njohuri për ekzistimin e planeve urbane, dhe ata që i kanë, i marrin ato kryesisht prej mediave dhe jo nga komunikimi i drejtpërdrejtë me komunën. Po ashtu është një numër shumë i vogël i qytetarëve që janë të informuar se mund të kontribuojnë mbi çështjet urbane në qytet. Informatat përkitazi me debatet me qytetarë të organizuara nga komuna në lidhje me çështjet urbanistike, i kanë vetëm 30% të qytetarëve, dhe përfundimisht vetëm 6% prej tyre kanë marrë pjesë në to. Një numër i madh i qytetarëve shprehen se nuk janë ftuar asnjëherë në debate publike nga organizatat e shoqërisë civile. Problemet që i kanë në lidhje me qytetin, qytetarët zgjedhin kryesisht t’i adresojnë personalisht në komunë.

Si në anketimet paraprake edhe këtu del në pah nevoja që komuna ta përforcojë komunikimin me banorët e vet përmes formave të ndryshme të informimit (posterë, sms, email, ftesë përmes mjeteve të informimit, flyerë, etj.) dhe në partneritet me organizatat që mbrojnë interesat e komuniteteve të caktuara, përtej formave standarde që i aplikojnë. Mobilizimi i qytetarëve përmes organizatave që mbrojnë interesat e komuniteteve të caktuara, mund të sjellë në debate edhe individë nga komunitetet e marginalizuara, zëri i të cilëve zakonisht mungon në debatet e tilla. Po ashtu, komunat duhet të fillojnë ndërveprimin e tyre me qytetarë përmes njësive më të vogla administrative, formale ose jo formale (p.sh. përmes këshillave lokale dhe organizimeve jo formale në lagje, etj.)

Në një proces gjithëpërfshirës të planifikimit, urban krahas ekspertëve të fushës, duhet të përfshihen edhe qytetarët jo-ekspertë, sepse qyteti përbëhet nga qytetarë jo-ekspertë, të

cilët, duke i njohur problemet e përditshmërisë<sup>9</sup>, mund të identifikojnë probleme dhe gjejnë zgjidhje më të përshtatshme në qytet.

Andaj, me qëllim të sigurimit që rezultatet e planifikimit dhe projektimit në qytet të përmbushin nevojat dhe të jenë në funksion të plotë të qytetarëve, i rekomandojmë komunës që të përfshijë konsultimet me qytetarët e lagjeve ku planifikohen intervenimet e caktuara, në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit: prej eksplorimit fillestar të problemeve, gjetjes së ideve për zgjidhjen e problemit, deri te fazat e zhvillimit të projektit, vlerësimit të zgjidhjeve të propozuara, etj. Secila mënyrë tjetër e organizimit të konsultimeve publike që nuk ka për qëllim pjesëmarrjen e vërtetë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes për projektet që lidhen ngushtë me mjedisin që e jetojnë, janë konsultime që bëhen për hir të përmbushjes së obligimit ligjor.

Siç u theksua më lartë, qytetarët mund të jenë të painformuar për mundësinë e dhënies së kontributit të tyre në këtë aspekt, andaj, është më se e rëndësishme që të ndërtohet një qytetari aktive, e cila ka njohuri mbi mjetet e veprimit qytetar dhe politik për ngritjen e çështjeve që e shqetësojnë komunitetin. Rol të rëndësishëm për ngritjen e një qytetarie aktive duhet ta kenë organizatat e shoqërisë civile, të cilat mbrojnë interesat e grupeve të caktuara të komunitetit, përmes formave të ndryshme të aktivizimit dhe avokimit.

Rëndësia e ndërtimit të një qytetarie aktive është e shumëfishtë. Mes tjerash, ajo e përforcon ndjenjën e komunitetit dhe atë të vendit. Për qytetarët aktivë demokracia nuk është më një term abstrakt: ata e zbulojnë shkathtësinë e vet për të bërë ndryshime, pasi ta kenë provuar vlerën e pjesëmarrjes në

vendimmarrje<sup>10</sup>. Me punën e tyre, qytetarët aktivë zhvillohen përtej ndërgjegjësimit rreth një problemi specifik, drejt përqafimit të një mendësie publike, dhe të një angazhimi më të gjerë për të mirën e komunitetit dhe qytetit në përgjithësi.

## 2. Trotuaret e zaptuara - barrierë për lëvizje të lirë dhe barrierë për pjesëmarrje qytetare

Një nga komponentët themelorë të lëvizjes për qytetarë në hapësirat urbane janë trotuaret – rrugët e këmbësorëve. Trotuaret janë ato pjesë të hapësirës publike në qytet, të cilat, pos që e krijojnë sipërfaqen e përshtatshme për ecje në publik, iu ofrojnë siguri këmbësorëve nga aksidentet e trafikut. Trotuaret e mira janë ato të cilat i akomodojnë së paku dy persona të rritur që të mund të ecin përbri njëri-tjetrit dhe janë të lira nga elementet horizontale dhe vertikale që e vështirësojnë ose pengojnë krejtësisht lëvizjen. Rruga si hapësirë publike ka funksione të shumëfishta. Ato ofrojnë vend për njerëzit që të ndërveprojnë me ata që kanë dalë nga qarqet e tyre private dhe mundësojnë vendim-marrje, artikulum të brengave publike dhe zgjidhje të problemeve të përbashkëta.<sup>11</sup>

Të lëvizësh në qytet është shumë më shumë sesa të marrësh makinë apo autobus për përmbajtje të caktuara. Për ta mundësuar lëvizjen në qytet, rrugët duhet të jenë të dizajnuara mirë dhe të menaxhuara dhe duhet që të mos jenë pengesë e lëvizjes. Si dhe nuk duhet parë trotuarin vetëm si një element që mundëson transportin këmbësorik, ai duhet të

<sup>10</sup> [http://newcity.ca/Pages/citizen\\_learning.html](http://newcity.ca/Pages/citizen_learning.html)

<sup>11</sup> Loukaitou-Sideris, Anastasia, Sidewalks: Conflict and Negotiation over Public Space (Urban and Industrial Environments, The MIT Press; 1 edition (May 29, 2009), (qasur ne Kindle format)

<sup>9</sup>Basha, R., Planifikimi urban për qytetarët 3, EC Ma Ndryshe, tetor 2014

ofrojë mundësi për përballje të përditshme të qytetarëve me njëri – tjetrin, për të vënë në pah konfliktet dhe problemet, si dhe për t'i negociuar zgjidhjet e mundshme.

Në Prizren janë pikërisht trotuaret ato pjesë të hapësirës publike, të cilat, me pengesat që i përmbajnë, e vështirësojnë lëvizjen dhe jo rrallë e rrezikojnë jetën e këmbësorit. Pengesat e lëvizjes në trotuare janë kryesisht rezultat i ngushtimit, zaptimit dhe bllokimit me vetura të parkuara, zgjerime të ndërtesave në përdhese dhe mallrat, reklamat dhe elementet e ndryshme të ekspozuara nga lokalet. Ky është një problem kritik, që shtrihet pa përjashtim në tërë qytetin.

Përgjigjet e qytetarëve në anketë dëshmojnë shkallën e lartë të zaptimit të trotuareve dhe sipërfaqeve të tjera publike si fenomen i kudogjendur në Prizren. Duke qenë se trotuaret në rrugët e qytetit të Prizrenit janë sipërfaqe në pronësi publike dhe se çfarëdo veprimi i zaptimit të tyre nga qytetarë apo pronarë lokalesh të papërgjegjshëm është shkelje ligji dhe pengim dhe vështirësim i rrjedhës normale të lëvizjes këmbësorike në qytet në përgjithësi, Inspektorati i Komunës së Prizrenit duhet të ndërmarrë masa konkrete për largimin e të gjitha pengesave si dhe lirim të trotuareve për shfrytëzim të qytetarëve.

Në veçanti, Inspektoratit komunal i rekomandohet që të:

- Të largojë të gjitha strukturat e ndërtuara (shkallë, plato dhe të ngjashme) nga përdhese dhe adaptuara në lokale, që me gabaritin e tyre ngushtojnë në masë kritike hapësirën për lëvizje të këmbësorëve,
- Të largojë vazot e betonit, pengesat e tjera, reklamat, malli i ekspozuar para lokaleve,

- Të largojë mobiliarin para lokaleve shërbyese në hapësira publike, aty ku ngushtohet kalimi i lirë të këmbësorëve,
- Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, të pengohet parkimi i veturave në trotuare dhe sipërfaqe të tjera të dedikuara për lëvizjen e këmbësorëve,
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, shtyllat e ndriçimit, elementet e tjera infrastrukturore, shportat dhe kontejnerët e mbeturinave, sinjalistika e rrugëve, të ripozicionohen asisoj që të mos e vështirësojnë shfrytëzimin e trotuareve nga ana e qytetarëve.

Për qytetarët e Prizrenit, një nga pyetjet më pak shqetësuese, del të jetë transporti publik. Kjo lë të nënkuptohet se shumë nga ta për relacione të shkurtra dhe të gjata përbrenda qytetit përdorin automjetet personale. Në një qytet me shtrirje të tillë gjeografike si Prizreni, është më se i nevojshëm një rrjet i zgjeruar i transportit publik, që do të mundësonte udhëtime të shkurtra por edhe vajtje-ardhje nga fshatrat fqinje për në qytet. Komuna do të mund të ndërmerre hapa për vendosjen e një rrjeti të tillë, dhe me këtë do të ndihmonte në lirim të trotuareve dhe rrugëve nga makinat e parkuara, dhe njëkohësisht do të ndikonte në lehtësimin e njërit prej shqetësimeve të mëdha të qytetarëve të Prizrenit, ndotjen e ajrit.

Në përmblyllje duhet ritheksuar se qyteti gjithëpërfshirës promovon zhvillimin përmes pjesëmarrjes së barabartë, ku të gjithë pavarësisht racës, etnisë, fesë e gjinisë fuqizohen dhe iu mundësohet që të marrin pjesë në mënyrë të plotë në planifikimin dhe vendim-marrjen. Një planifikim dhe qeverisje gjithëpërfshirëse do të ndikonte në: zvogëlimin e pabarazive dhe uljen e tensioneve sociale; inkorporimin e dijes, produktivitetit, kapitalit shoqëror dhe fizik të të varfërve dhe të të

margjinalizuarve në zhvillimin dhe planifikimin e qytetit. Të promovosh gjithëpërfshirjen në qytet nuk është vetëm çështje e drejtësisë shoqërore, por edhe çështje qendrore e zhvillimit të qëndrueshëm urban. Planifikimi pjesëmarrës ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve që mund të integrohen në projektet zhvillimore urbane dhe që i adresojnë problemet dhe shqetësimet e të gjithëve dhe me këtë do të përmirësojnë qeverisjen urbane. Gjatë planifikimit gjithëpërfshirës, puna me grupet e ndryshme të interesit nxjerr mekanizma dhe prodhon mjete që zgjidhin probleme përbrenda komunitetit, të cilat pastaj mund të adaptohen lehtë për t'u funksionalizuar dhe zbatuar në projekte konkrete urbane.

Andaj, një qytet si e mirë e përbashkët, që mëton zhvillim të qëndrueshëm, ngrihet nga një shoqëri gjithëpërfshirëse përmes proceseve pjesëmarrëse. Ai mbështet zhvillimin e plotë të potencialit dhe aftësive njerëzore dhe është për të gjithë, meqë bazohet në nevojat e tyre, si dhe ndërtohet nga të gjithë duke u bazuar në aftësitë (mundësitë) e tyre<sup>12</sup>.

---

<sup>12</sup> Basha, R., Planifikimi urban për qytetarët 3, EC Ma Ndryshe, tetor 2014

## EC Ma Ndryshe

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse.

EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe:

-Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit) – Mobilizimi i komunitetit përbën thelbin e punës së EC-it. Identiteti i organizatës rrjedh nga angazhimi komunitar. Qyteti Gjithëpërfshirës do të jetë programi më i rëndësishëm i organizatës dhe do të përfaqësojë tiparin dallues të EC-it në raport me organizatat tjera të shoqërisë civile. Pjesë e këtij programi do të jenë veprimet që nxisin aktivizmin qytetar në nivel të grupeve të komunitetit (kryesisht lagjet urbane).

-Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim) –Për t'u siguruar që qeveria lokale vepron në përputhje me kërkesat dhe interesat e grupeve të komunitetit dhe për të mbajtur gjallë presionin publik ndaj autoriteteve, programi i Qeverisjes së Mirë do të strukturohet rreth aktivitetit të monitorimit të transparencës dhe rolit watchdog të organizatës. Monitorimi është një ndër tiparet më dalluese të punës së EC-it, ndërsa ai është dizajnuar në atë formë që do t'i ushqejë dy programet e tjera të organizatës me informacion të bazuar, të shpejtë dhe kredibil.

-Hulumtimi (prodhim i dijes) –Prodhimi i dijes do të jetë një nga sferat e angazhimit të përhershëm të organizatës. Duke ndërtuar mbi produktet e hulumtimit të prodhuara në vitet e fundit, organizata do të ndërtojë një sistem të strukturuar të hulumtimit dhe prodhimit të dokumenteve të politikave. Programi i hulumtimit do të forcojë edhe më tutje kapacitetin prodhues të organizatës dhe do të përmirësojë kompetencën profesionale në fushat e ngushta të angazhimit.

Tiparet dalluese të EC janë: një, fokusi gjeografik, dhe dy, qasja ndaj çështjeve të interesit. E bazuar në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike në hulumtimin dhe zhvillimin e politikave. Si rezultat, produktet e hulumtimit të organizatës ofrojnë përmbajtje të besueshme, pasi që merren me thelbin e problemit në vend se me simptomat. Për më tepër, EC mbulon fusha të veçanta sikur planifikimi urban, politikat kulturore, menaxhimi i hapësirës publike dhe të ngjashme, të cilat janë përgjithësisht të nëntrajtuara në Kosovë. Aktiviteti hulumtues dhe aktivizmi grassrootsi i organizatës janë metoda pune të kombinuara mirë dhe të ndërvarura. Përmes aktivizmit, EC angazhohet në mënyrë të përhershme në punë me grupet e komunitetit për t'i identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë burime që e ushqejnë komponentën e hulumtimeve. Kjo metodologji mundëson ndikim më të madh tek agjenda e politikëbërjes, pasi që idetë vijnë nga poshtë, ndërsa paralelisht krijohen mundësi për përfshirjen e politikëbërësve në një debat konstruktiv dhe të mirëinformuar. Me këtë qasje, organizata ndikon në pjesëmarrje më të gjërë publike dhe procese më gjithëpërfshirëse të zhvillimit të politikave publike.

Projektet kryesore të organizatës gjatë viteve të fundit: EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse (2015–2016), Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale (2015–2016), Urbanizmi I Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013–2016), Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014–2015), Qyteti Gjithëpërfshirës, planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013–2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014–2016), Zhvillimi rajonal përmes

turizmit kulturor (2014–2015), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale (2013–2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit lokal dhe rajonal në Prizren (2013–2015), Pjesëmarrja publike në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2012 –2013), Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012–2015), Një tregim ballkanik (2011–2012), Aktivizmi qytetar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (2009–2010).

Publikimet e fundit të organizatës: Zhdukja e Gjurmëve – Qendrat historike të Kosovës (2015), Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore (kontribut për raportin e Progresit) (2015), (Pa)drejtësia në urbanizmin e Prizrenit (2015), Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren (2015), Katalogu i Rajonit të Prizrenit (2015), Planifikim urban për qytetarët (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Ku është kalldrëmi i Prizrenit? (2014), Paraja publike si “paret e babës” (2014), Udhëzues për transparencën në komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike të Prizrenit (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014).